



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 03.09. 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 4 datë 21/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiarë dhe ligjorë"

Analiza ligjore: Projekt vendimi është në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Veteqeverisjes Vendore të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara nga detyrimet kontraktore"; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 27.02. 2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"; dhe të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.26, datë 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e veshtirësive financiare për njësitë e veteqeverisjes vendore" si dhe relacionit të administratës:

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Detyrimet, të cilat Bashkia propozon, që të hiqen nga kontabiliteti, janë detyrime që i perkasin vitit 2013 e më parë të krijuara nga Bashkia dhe ish komunat, të cilat janë kontabilizuar në mënyrë jo të sakte pa patur dokumentacionin perkates.

Peshën me të madhe në këto detyrime e ka zeri shërbimeve në vlerën 4,859,512 leke për të cilat janë mbartur vit pas viti në kontabilitet dhe nuk disponohet dokumentacion ose procedure për likuidimin e tyre, kanë mbyllur aktivitetin.

Më paraqitjen e dokumentacionit financiarë dhe ligjorë do të mundësohet serish kontabilizimi i tyre.

Detyrime për investime rezultojnë 1,286,759 lekë dhe këto nuk kanë dokumentacion justifikues të sakte për të bërë likuidimin.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për miratimin e projektvendimit "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiarë dhe ligjorë"

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme drejtorinë e Finances ose Drejtorinë përgjegjëse për informacione të tjera të nevojshme.

Impakti social / grupet që preken: Dokumenti i propozuar "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiarë dhe ligjorë" ndikon në gjendjen financiare të Bashkisë.

A është objekt i konsultimit publik: Projekt vendimi nuk është objekt konsultimi me publikun.

Komisioni i Përhershëm për "Ekonomi dhe Financë", i mbledhur me datën 03.09. 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.4 datë 21/08/2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiarë dhe ligjorë" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

 **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



Datë 03 .09. 2025

